



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/39

Datë: 03.06.2020


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 119 paragrafi 9 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ndryshuar me ligjet Nr. 04/L-111 dhe Nr. 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 qershor 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Secila ndërmarrje publike qendrore duhet të krijojë një sistem të mirëfilltë dhe të njëzuar të menaxhimit të kontratave komerciale.
2. Asnjë ndërmarrje publike qendrore nuk mund të lidhë kontratë komerciale pa pëlqimin e ministrit përgjegjës nëse kontrata përmban:
 - 2.1. klauzolë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me arbitrazh ndërkombëtar;
 - 2.2. klauzolë për zbatimin e së drejtës së huaj; ose
 - 2.3. detyrim të ndërmarrjes publike qendrore për të paguar dënim kontraktues ose dëmshpërblim të likuiduar, nëse dënimi ose dëmshpërblimi tejkalon gjithsej 5.000,00 € (pesë mijë euro).
3. Çdo kontratë komerciale mes një ndërmarrjeje publike qendrore dhe një operatori ekonomik të regjistruar në Republikën e Kosovës duhet të jetë në njërën ose të dy gjuhët zyrtare.
4. Të gjitha ndërmarrjet publike qendrore duhet të ushtrojnë kujdes që shpenzimet operative dhe punësimet e reja të mos cenojnë likuiditetin e ndërmarrjes.
5. Asnjë ndërmarrje publike qendrore nuk mund të caktojë pagë në lartësi mbi 2.500,00 € (dy mijë e pesëqind euro) në muaj për një zyrtar të saj pa pëlqimin e ministrit përgjegjës.
6. Secila ndërmarrje publike qendrore duhet të mirëmbajë sajtin e vet dhe të botojë dokumentet që kërkohet të jenë publike sipas ligjit.
7. Secila ndërmarrje publike qendrore që ofron shërbime për qytetarët duhet të mundësojë pagimin elektronik të faturave.
8. Ndërmarrjet publike qendrore në sektorin e ujërave duhet të planifikojnë zvogëlimin e humbjeve teknike dhe komerciale.

9. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë